


Kërko

POP 5


Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



1 SPAK goditi 8 grupe kriminale, Report Tv siguron DOSJEN e plotë! Akuzat, ngjarjet kriminale dhe dëshmitë! Emrat e 18 të arrestuarve dhe 14 në arrati! 500 mijë euro për një vrasje



2 Vrasja e Ervis Dedës, rrëfhet Dumani: Festim Qoli e Henrik Hoxha e pranuan ekzekutimin, paguan 200 mijë euro drejtësinë për të mbyllur çështjen



3 FOTO EKSKLUZIVE/ Kallashnikov, kanabis dhe doreza, çfarë gjeti policia në hotelin e Ervis Martinajt, në operacionin për arrestimin e tij



4 kaloi

Kronikë

Vrasja e 48-vjeçarit në Sukth/ Të shoqëruar 20 persona, autorët të maskuar, e kanë mbajtur në vëzhgim prej kohësh, djali i mitur pa babanë e plagosur, lajmëroi fqinjët dhe e çoi në spital

Të paktën 20 persona janë shoqëruar në polici për t'u pyetur lidhur me atentatin e mbrëmshëm në Sukth të Durrësit, ku u ekzekutua Arben Mërkuri, i njohur si Maneci. Report Tv mëson se kamerat e sigorisë kanë fiksuar 2 autorë, por identifikimi i tyre por identifikimi i tyre është i vështirë.

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com

Vrasja e 48-vjeçarit në Sukth/ Të shoqëruar 20 persona, autorët të maskuar, (^

**Redaksia**19 Maj, 10:08 | **Përditesimi i fundit: 19 Maj, 13:11**

Share 12

Tweet



DURRËS- Personi i parë që e ka parë të shtrirë në tokë Arben Mërkurin, të plagosur nga plumbat, është djali i mitur i 48-vjeçarit. I tmerruar nga ajo se çfarë kishte ndodhur, djaloshi ka njoftuar fqinjët të cilët e kanë ndihmuar që ta çojnë me makinë babanë e tij në spital, por si pasojë e plagëve të marra, Mërkuri, i njohur si 'Maneci i Sukthit', nuk ia doli që të mbijetonte.

Kur ende nuk kanë kaluar 24 orë, hetuesit kanë zbërthyer mënyrën se si është ekzekutuar Arben Mërkuri (Ismaili) një ditë më parë në biznesin e tij në qendër të Sukthit. Report Tv ka mësuar se kanë qenë 3 autorë, një shoferi, një personi që ekzekutoi 48-vjeçarin dhe një tjetër që ka mbajtur në vëzhgim prej kohësh Mërkurin deri në moment "ideal" për ta ekzekutuar. Referuar burimeve, 2 prej tyre janë kapur nga kamerat e sigurisë, por kanë qenë me maskë. **RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com** vështirë për ai identifikimin e tyre. Mërkuri sapo zbriti nga makina e tij është qëlluar me presneri plumbash, por ai

ka tentuar që t'u shpëtoj duke u futur në ambientet e dyqanit. Kjo nuk e ka ndihmuar, pasi njëri prej autorëve e ka ndjekur duke e plagosur rëndë. 12 gëzhoja automatiku janë gjetur në vendin e ngjarjes, teksa shenjat e plumbave janë ende të dukshme në dritaret e biznesit në qendër të Sul dhe në makinën e tij.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:

Dy të penduar të drejtësisë, Nuredin Dumani dhe Henrik Hoxhaj zbërthejnë vrasjet nga 8 grupe kriminale në një dekadë! 32 urdhër-arreste, 18 të arrestuar, 14 në kërkim

Të paktën 20 persona janë shoqëruar, 10 prej tyre dëshmitarë okularë të cilët kanë deklaruar përballë uniformave blu se kanë dëgjuar të shtënat me armë dhe përplasjen e dyerve të makinave, ku sipas tyre autorët kanë lëvizur me një makinë tip Benz 'GLE' ngjyrë gri, e cila është larguar drejt autostradës.

Pista kryesore e hetimit është ajo e përfshirjes në konflikte të mëparshme dhe larje hesapesh, pasi Mërkuri është një emër i njohur për policinë e qytetit dhe jo vetëm. 'Maneci' dyshohet i përfshirë edhe në dhunën e ushtruar ndaj biznesmenit amerikano-libanez, **Faadi Mitri** pranë kryqëzimit të Laknasit, pasditen e 10 shtatorit 2016 për shkak të investimit që po kryente në zonën e Gjirit të Lalzit. Por përveç kësaj ngjarjeje, ai dyshohet edhe si vrasës me pagesë, por që asnjëherë nuk u arrit të dokumentohej.

Arben Mërkuri njihet si mik i Landi Muharremi, Rrumit të Shijakut, por që për shkak të një konflikti nuk shoqëroheshin më. Landi Muharremi ka qenë në makinë me prokurorin **Arjan Ndoji** ditën që këtij të fundit iu bë atentat, ku mbeti i vrarë shoferi i prokurorit. 48-vjeçari ka qenë gjithashtu një nga personat e dyshuar që ka marrë pjesë në ekzekutimin e 4 viteve më parë të **Ervin Dalipajt** dhe Juxhin Dautajt.

Mërkuri ka në pronësi një objekt 3 katësh, një dyqan kancelari, një market në Sukth, një dyqan që ende nuk e kishte hapur, ku dhe ndodhi ngjarja si edhe një kompani që merret me mbarështimin e pulave. Madje së fundmi ai është përfshirë në një ngjarje ku ka tentuar që t'i thyejë kamerën një gazetareje investigative, pasi po denonconte se ka groposur pulat me grip shpendësh në mënyrë të paligjshme. Nga sa mësohet, në Itali ishte i dyshuar se ka vrarë një prostitutë, ku edhe një video shihet teksa thotë se "deri dje i bënte femrat copa-copa", dhe se tani kishte ndryshuar pasi ka vetë

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com



një vajzë.



Rendit zhvillimet sipas orarit: [Të Fundit](#)

Ora 10:49

Atentati në Sukth/ Report Tv sjell pamjet nga dyqani i 48-vjeçarit, shenjat e plumbave në derë

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com



Atentati në Sukth/ Report Tv sjell pamjet nga dyqani i 48-vjeçarit, shenjat e p



Report Tv sjell pamje nga dyqani ku u ekzekutua 48-vjeçari Arbën Mërkuri, në Sukth. Në pamjet duken shenjat e plumbave në derë të biznesit që priste të hapte Mërkuri në qendër të Sukthit.

Share 1



B.K./Shqiptarja.com

TAG: vrasja e arben merkurit Durres sukth Arben Merkoci

Komento

Komente

faik:

19/05/2022 14:53

Kur nuk vepron drejtesia vepron vetgjyqesia, ky dihet qe ishte nje kriminel vrases....

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com

Për

GetButton



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:****A mendoni se Presidenti i ri do të jetë një prej emrave të propozuar nga opozita?**

PO

JO

NUK E DI

Lajme të tjera

Kronikë

**Sukth/ Ekzekutohet në dyqanin e tij 48-vjeçari me 2 mbiemra! I përfshirë në 2016 në dhunën ndaj biznesmenit libanez, dyshohet vrasës me pagesë**

18 Maj, 20:42

Kronikë

**Sekuestrimi i 59 kg kokainë në anijen me qymyr në Durrës, po kryhet kontroll me polumbarë në pjesën e poshtme të anijes! Merret në pyetje ekuipazhi, deri tani asnjë në pranga****Arsen Rusta**

18 Maj, 12:43

Politikë

Berisha nga Durrësi: Ishim lolo dhe vegël e qeverisë për shportin në duart e qytetarëve dhe Dubain atje ku është

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton



17 Maj, 19:28



Kronikë



**40-vjeçari i sëmurë humb kontaktet prej 2 ditësh!
Familja kërkon ndihmën e të gjithëve**

17 Maj, 18:05


Kronikë



**Me kapele, kufje dhe çantë, del fotoja e autorit të
plagosjes së Ardit Kërtushës dje në lokalin e Noizyt
në Durrës! 31-vjeçari: Ishte atentat i mirëfilltë ndaj
meje**

17 Maj, 10:16

Kronikë



**Trafikantët 'braktisin' bananet, drogë me anije qymyri!
Kapen mbi 60 kg kokainë (53 pako) në portin e
Durrësit, vinte nga Kolumbia! Policia shqiptare u
njoftua nga partnerët**

17 Maj, 07:05

Ekonomi

**Rritja e çmimeve vonon rindërtimin në Shijak, shtrenjtohen materialet e ndërtimit
specialisti: Rriten kostot për kompanitë**

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com



GetButton



Aldo Mustafa

16 Maj, 18:07

Kronikë



U plagos me armë zjarri në lokalin e Noizyt në Durrës, ish-kandidati për kryetar i PS-së: Ishte atentat i mirëfilltë, do kryhej nga vrasës me pagesë

16 Maj, 14:01


Kronikë



Durrës/ Tentoi të kalonte kufirin me dokumente të falsifikuara, arrestohet kosovari

16 Maj, 11:31

Kronikë



Humbi kontrollin dhe doli nga rruga, përmbysët kamioni në Fushë-Krujë, përfundon te 'Trauma' shoferi

15 Maj, 11:34

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com



Kultura



Speciale/ Për herë të parë transmetohen pamje të vilës mbretërore... Vila e Zogut para dhe pas plaçkitjes së vitit 1997



Artur Korriku



Yllka Kamenica

12 Maj, 12:48

Politikë



Berisha i përgjigjet Ramës, e fton për debat publik: Eja të ballafaqohemi! Ne nuk bëjmë presion, nëse ka afera të pahetuara janë viktimat e Thumanës

11 Maj, 13:03

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com





Kerko

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com

